



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 31

Tiranë – E enjte, 23 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 8/2017 datë 2.2.2017	Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit..... 2029
Ligj nr. 12/2017 datë 9.2.2017	Për disa shtesa në ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar..... 2033
Ligj nr. 13/2017 datë 9.2.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, mbi transportin detar tregtar..... 2033
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.2.2017	Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike..... 2037
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 4, datë 9.2.2017	Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga granti 1 “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2017..... 2039



LIGJ
Nr. 8/2017

PËR STATUSIN E PUNONJËSVE TË
INDUSTRIË SË NAFTËS DHE TË GAZIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton statusin e punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit, i cili përfshin pozitën juridike, ekonomiko-financiare dhe shoqërore, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe ish-punonjësve të industrisë së naftës e të gazit në Republikën e Shqipërisë, për arsye të karakterit të veçantë të punës dhe ndikimin e saj në shëndet, si dhe garancitë ligjore për zbatimin e tyre.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ish-naftëtar” është shtetasi që ka punuar në industrinë e naftës dhe të gazit në profesionin dhe punën e përcaktuar në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, ish-punonjësit e uzinave mekanike të naftës dhe personeli inxhiniero-teknik, që kanë punuar në ish-ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhimit, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, mekanikës, institutet gjeologjike dhe teknologjike, përpunimit, transportit me naftësjellës dhe gazsjellës.

2. “Naftëtar” është shtetasi që punon në industrinë e naftës e të gazit në profesionin dhe punën e përcaktuar në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, punonjësit e uzinave mekanike të naftës dhe personeli inxhiniero-teknik, që punon në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhimit, sizmikës, gjeofizikës

kantieriale, mekanikës, institutet gjeologjike dhe teknologjike, përpunimit, transportit me naftësjellës dhe gazsjellës.

Neni 3
Përfituesit

1. Statusin e punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit e përfitojnë të gjithë shtetasit që kanë punuar dhe punojnë në industrinë e naftës dhe të gazit, sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji.

2. Këtë status e përfitojnë edhe ata persona që janë të aksidentuar në punë, pavarësisht kohëzgjatjes së punës në këtë industri.

3. Personat që përfitojnë statusin, sipas përcaktimeve të këtij ligji, pajisen me dëshmi zyrtare identifikuese, e cila lëshohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit. Në dhënien e dëshmisë shërbejnë dokumentet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Rregullat e organizimit, funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni, si dhe formati i dëshmisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për këtë industri.

Neni 4
Marrja e statusit

E drejta për marrjen e statusit të punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit lind që nga data e fillimit të punës në industrinë e naftës dhe të gazit, në një nga profesionet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

Neni 5
Dokumentet për statusin

Qenia naftëtar ose ish-naftëtar vërtetohet me këto dokumente:

1. Për ish-naftëtarin, librezat e punës, e shoqëruar nga një vërtetim i posaçëm zyrtar, i lëshuar nga ndërmarrja ose institucioni ku ka qenë i punësuar personi, i konfirmuar nga ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit, në të cilin përcaktohen kryerja e aktivitetit të punës, sipas nenit 2, të këtij ligji, dhe kohëzgjatja e punës.

2. Për ish-naftëtarin që ka dalë në pension, vërtetimi i posaçëm lëshohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe konfirmohet nga ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit.

3. Për naftëtarin që është i punësuar në industrinë e naftës dhe të gazit, librezat e punës, e



shoqëruar me vërtetimin e posaçëm, të lëshuar nga ndërmarrja ose institucioni ku është i punësuar, dhe i konfirmuar nga ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit, në të cilin përcaktohen kryerja e aktivitetit të punës sipas nenit 2, të këtij ligji, dhe kohëzgjatja e punës.

4. Për ish-naftëtarët dhe naftëtarët në marrëdhënie pune, konsiderohet punë në industrinë e naftës e të gazit edhe periudha e punës në të njëjtin profesion ose ekuivalente me të, në shtete të tjera, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore.

5. Kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar, sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Paga dhe shtesat mbi pagë

1. Paga e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit përcaktohet sipas kontratës kolektive të punës dhe reflekton të gjitha detyrimet e Kodit të Punës, si dhe vështirësitë e veçanta që ka puna në këtë industri dhe ndikimin e saj në shëndet.

2. Paga e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit nuk mund të jetë më e ulët se 150 për qind e pagës minimale në shkallë vendi.

Neni 7

Vjetërsia në punë

Njihet si vjetërsi në punë, si punonjës i industrisë së naftës e të gazit, për efekt shpërblimi dhe përfitimi financiar, si dhe përfitimi nga sigurimet shoqërore, periudha e punës e kryer në profesionet, sipas nenit 2 të këtij ligji, e vërtetuar sipas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 8

Shpërblimi financiar pas ndërprerjes së punës

1. Personat, që gëzojnë statusin e naftëtarit dhe që kanë vjetërsi pune, sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij ligji, burrat mbi 20 vjet dhe gratë mbi 15 vjet dhe që janë të papunë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç përparësisë në punësim, kanë të drejtën e një përfitimi financiar, i cili, në asnjë rast nuk mund të jetë më i vogël se 80 për qind e pagës minimale në shkallë vendi. Masa, kohëzgjatja dhe procedura e përfitimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personat, që gëzojnë statusin e naftëtarit dhe që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dalin të papunë si rezultat i rishtrukturimit të ndërmarrjes apo për shkaqe që nuk lidhen me ta, gëzojnë përparësi në punësim dhe përfitojnë nga punëdhënësi një shpërblim financiar në masë dhe kohëzgjatje, sipas përcaktimeve të kontratës kolektive të punës, por jo më pak se 80 për qind të pagës minimale në shkallë vendi dhe jo më pak se tre vjet.

Neni 9

Mosha e daljes në pension dhe kushtet e përfitimit

1. Kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie, si punonjës të industrisë së naftës dhe të gazit, punonjësit të cilët plotësojnë këto kushte:

a) burrat që mbushin moshën 60 vjeç dhe kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 20 vjet në punë, sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji;

b) gratë që mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 25 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 15 vjet në punë, sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji.

2. Bëjnë përjashtim nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, personat që kanë kryer punë si operator (përgjegjës kyç) dhe ndihmësoperator (punëtor pastrimi), traktorist në brigadat e remontit nëntokësor të puseve të naftës e të gazit, kryesondator, pontist dhe punëtor i kyçit në shpimin e puseve të kërkimit dhe të zhvillimit të vendburimeve, punonjës në repartet e koksit të rafinerive të naftës dhe punëtorët e pastrimit të brendshëm të rezervuarëve, depove dhe cisternave të naftës në industrinë e përpunimit të naftës dhe të gazit. Mosha e daljes në pension për këta persona është 55 vjeç për burrat dhe 50 vjeç për gratë dhe me periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë për burrat dhe 25 vjet e më shumë për gratë dhe vjetërsi në këto profesione sa gjysma e vjetërsisë së përgjithshme.

Neni 10

Masa e pensionit

1. Pensioni llogaritet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit, që gëzojnë statusin e naftëtarit dhe që dalin në pension ose kanë dalë në pension, përfitojnë shtesë



pensionin në masën 1 për qind për çdo vit pune, e përcaktuar sipas neneve 2 dhe 7, të këtij ligji, por jo më shumë se 40 për qind të pensionit të pleqërisë.

Neni 11

E drejta për përfitim

1. E drejta për të përfituar pensionin e pleqërisë, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.

2. Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë:

a) nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte;

b) nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.

3. Personi, i cili ka përfituar pension pleqërie, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve mujore të pensionit të pleqërisë për periudhën/periudhat, gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetëpunësuar apo punëdhënës, me përjashtim kur vetëpunësohet në bujqësi.

4. Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

5. E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.

6. Personi, i cili ka përfituar pension dhe kompensime në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të pensionit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Neni 12

Financimi

1. Përfitimet nga ky ligj financohen nga kontributet shtesë, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe nga Buxheti i Shtetit.

2. Për personat, të cilët kryejnë punë në industrinë e naftës dhe të gazit, në profesionet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji, do të paguhet kontribut shtesë në masën 5 për qind të pagës bruto. Kontributi shtesë paguhet 3 për qind nga punëdhënësi dhe 2 për qind nga punëmarrësi.

3. Kontributi i sigurimeve shoqërore në masën 5 për qind mbledhet dhe derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme, sipas procedurave për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Diferenca ndërmjet efektit financiar të këtij ligji, deri në plotësimin e moshës së përfituesve, sipas nenit 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me kontributin shtesë, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

5. Procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore, sipas pikës 4, të këtij neni, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 13

Kërkesa për përfitim nga statusi i naftëtarit

1. Përfitimi i pensionit, sipas përcaktimeve të neneve 9, 10, 11 e 15, të këtij ligji, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij.

2. Përfitimi financiar, sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 1, të këtij ligji, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Këshilli i Ministrave miraton politika dhe masa mbështetëse për punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit për plotësimin e nevojave të tyre për strehim.

Neni 14

Indeksimi

Përfitimet, sipas këtij ligji, indeksohen çdo vit sa herë indeksohen edhe pensionet e caktuara, sipas



ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Indeksi dhe koha e zbatimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Llogaritja e pensionit

Llogaritja, caktimi, administrimi dhe pagimi i pensioneve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave në fuqi për pensionet, në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 16

Trajtimi mjekësor dhe social

1. Përfituesit e statusit të naftëtarit dy herë në vit duhet të bëjnë kontrolle mjekësore falas në institucionet shtetërore apo private në vend. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ndërton ose detyron kompanitë që operojnë në industrinë e naftës dhe të gazit të ndërtojnë qendra mjekësore të pajisura me aparatura dhe mjekë specialistë që trajtojnë problematikën shëndetësore të shkaktuar nga puna në këtë industri:

a) Në rast sëmundjesh që vërtetohet se vijnë direkt ose indirekt nga puna në industrinë e naftës e të gazit, përfituesit e statusit të naftëtarit përfitojnë kurim falas në institucionet publike apo private që janë në marrëdhënie me FSDKSH-në. Nëse kurimi nuk ofrohet nga këto institucione, përfituesit e statusit kurohen në institucione private brenda vendit që ofrojnë këtë kurim dhe financohet nga Buxheti i Shtetit për ish-naftëtarët dhe nga kompanitë për personat që janë të punësuar.

b) Në rastet e sëmundjeve që vërtetohet direkt ose indirekt nga puna në industrinë e naftës dhe të gazit, që nuk kurohen brenda vendit, përfituesit e statusit duhet të kurohen falas jashtë vendit. Financimi i kurimit jashtë vendit bëhet nga Buxheti i Shtetit për ish-naftëtarët dhe nga kompanitë për personat që janë të punësuar.

2. Përfituesit e statusit të naftëtarit, që janë në marrëdhënie pune, përfitojnë pushim vjetor shtesë, të paguar, në masën 25 për qind të ditëve të punës që përcaktohen në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 17

Përfitime të tjera

1. Personat që gëzojnë statusin e punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit, sipas këtij ligji, janë përfitues në privatizimin e industrisë së naftës dhe të gazit në raport me kohën e punës, shkallën e kualifikimit e të kategorizimit të punës. Kriteret, masa dhe procedurat e përfitimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Në rastet e koncesioneve në industrinë e naftës dhe të gazit, në marrëveshjen e koncesionit duhet të përcaktohet detyrimi i koncesionarit për të krijuar një fond profesional pensioni, sipas ligjeve që administrojnë këto fonde, me jo më pak se 10 për qind të pagës bruto të punonjësve.

Neni 18

Detyrimet e organeve të pushtetit vendor

Organet e pushtetit vendor, në zonat ku banojnë përfituesit e statusit të naftëtarit kujdesen për punësimin e tyre në rast papunësie dhe krijimin e kushteve për përfituesit e pensionit.

Neni 19

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 3; 5, pika 5; 8, pika 1; 13, pika 2; 14 dhe 17, pika 1, të këtij ligji.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10014, datë 20.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 12/2017

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9874,
DATË 14.2.2008, “PËR ANKANDIN
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 17 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, përdoret vetëm për mallrat e konfiskuara të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.”.

Neni 2

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Procedura me negociim, pa shpallje
paraprake të njoftimit

1. Autoriteti shitës mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe me rregullat e ankandit publik, kur:

a) natyra e objektit nuk lejon zbatimin e afateve të përcaktuara në nenin 28, të këtij ligji, dhe përcaktimin e çmimit të plotë, në veçanti në rastet e:

i) shitjes së gjësë së gjallë;

ii) shitjes së mallrave të konfiskuara (fruta, perime, bulmet, mish dhe çdo mall i kësaj natyre) që ndryshojnë natyrë në një kohë relativisht të shkurtër apo mund të jenë në prag skadence, për të cilat është i domosdoshëm tjetërsimi i tyre.

2. Në çdo rast të përdorimit të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, autoriteti shitës duhet të sigurojë dhe të respektojë parimet e ofertës më të mirë, të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

3. Përdorimi i procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, nga autoriteti shitës nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës ndërmjet kandidatëve.”.

Neni 3

Në nenin 23, pika 1, pas fjalëve “me negociim” shtohen fjalët “me shpallje paraprake të njoftimit të ankandit”.

Neni 4

Në nenin 28, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 3 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë kandidatëve.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2017

Shpallur me dekreten nr. 10015, datë 20.2.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 13/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
BOSNJË–HERCEGOVINËS,
MBI TRANSPORTIN DETAR TREGTAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë - Hercegovinës mbi transportin detar tregtar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10016, datë 20.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-
HERCEGOVINËS
MBI TRANSPORTIN DETAR TREGTAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjë-Hercegovinës (më tej referuar si “Palët Kontraktuese”),

duke njohur rëndësinë e promovimit të zhvillimit të transportit detar tregtar, ndërmjet dy vendeve të tyre, bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok,

duke dashur fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e transportit të mallrave detare tregtare, bazuar në parimin e lirisë së transportit,

kanë rënë dakord sa vijon:

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “anije e Palës Kontraktuese” nënkupton çdo anije, regjistruar në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese dhe që mban flamurin e atij vendi, si edhe çdo anije me qira—me afat. “Anije e marrë me qira” nënkupton çdo anije, regjistruar në një shtet të tretë, në përputhje me legjislacionin e vet, që mban flamurin e këtij shteti dhe që drejtohet nga personi fizik ose juridik i një

prej Palëve Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre. Ky term nuk përfshin luftanije dhe anije të tjera, të përdorura për qëllime jotregtare, si edhe hidrografike, kërkime shkencore dhe anije peshkimi.

2. Termi “anëtar ekuipazhi” nënkupton kapitenin e anijes ose çdo person, të përfshirë në listën e ekuipazhit, që kryen detyra në bordin e një anijeje, në lidhje me funksionimin e saj, mirëmbajtjen dhe servisin gjatë udhëtimit.

3. Autoritetet kompetente, janë:

për Republikën e Shqipërisë – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;

për Bosnjë-Hercegovinën – Ministria e Komunikimeve dhe e Transportit e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 2

Kjo Marrëveshje zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 3

1. Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, në fushën e transportit detar tregtar, do të bazohet në parimet e barazisë, njohjes së sovranitetit kombëtar dhe interesave të përbashkëta.

2. Palët Kontraktuese duhet t'i japin njëra-tjetrës çdo ndihmë të mundshme për zbatimin e parimit të lirisë në transportin detar tregtar dhe do t'i shmangen marrjes së ndonjë mase, e cila mund të pengojë lundrimin ndërkombëtar.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve, organizatave dhe autoriteve, që veprojnë në fushën e transportit detar në vendet e tyre.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese kanë rënë dakord:

a) të nxisin përfshirjen e anijeve të Palëve Kontraktuese në sigurimin e shërbimeve të transportit detar ndërmjet porteve të vendeve të tyre;

b) të bashkëpunojnë për eliminimin e pengesave, që mund të dëmtojnë zhvillimin e transportit ndërmjet porteve të vendeve të tyre;



c) të abstenojnë për të mos penguar anijet e një prej Palëve Kontraktuese, për të siguruar shërbimet e transportit detar ndërmjet porteve të Palës tjetër Kontraktuese dhe porteve të shteteve të treta.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të cenojnë të drejtën e anijeve të vendeve të treta të marrin pjesë në shërbimet e transportit detar ndërmjet porteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 6

1. Secila Palë Kontraktuese do t'i japë ndihmë anijeve të Palës tjetër Kontraktuese, të njëjtën ndihmë që do t'u jepte anijeve të veta, në lidhje me hyrjen e lirë në porte, sigurimin e vendeve të ankorimit kalatë, veprimet e ngarkimit dhe të shkarkimit, të hipjes dhe zbritjes në anije të pasagjerëve, të taksave portuale të vendosura dhe shërbimet e përdorura, kur ato lidhen me anijet tregtare detare.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni *nuk do të*:

a) zbatohen për portet e mbyllura për anijet e huaja;

b) zbatohen për aktivitetet, të rezervuara nga secila prej Palëve Kontraktuese për ndërmarrjet dhe organizatat e tyre, të tilla si veprime shpëtimi kabotazhi (lundrim anës detit) dhe rimorkimi;

c) zbatohen për përjashtime nga rregullat për pilotim të detyrueshëm;

d) cenojnë zbatimin e rregulloreve në lidhje me pranimin, qëndrimin dhe largimin e të huajve të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 7

Palët Kontraktuese, brenda kuadrit të legjislacionit të tyre kombëtar, do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar dhe promovuar transportin detar, për të shmangur ndalimin e pajustificuar të anijeve, si edhe për të përshpejtuar dhe lehtësuar sa të jetë e mundur, doganën dhe të gjitha formalitetet e tjera të aplikueshme në portet e tyre.

Neni 8

1. Secila Palë Kontraktuese do të njohë dokumentet, që vërtetojnë shtetësinë kombëtare të anijeve, certifikatat e tonazhit dhe çdo dokument tjetër zyrtar anijeje, lëshuar dhe njohur nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Anijet e secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë certifikata tonazhi ndërkombëtar do të jenë të përjashtuara nga çdo masë tjetër në portet e Palës tjetër Kontraktuese. Këto certifikata do të përdoren si bazë për llogaritjen e tarifave portuale.

Neni 9

1. Secila Palë Kontraktuese do të njohë dokumentet e identitetit të marinarit, lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dokumente të tilla identiteti do të jenë:
për Republikën e Shqipërisë – “libreza e marinarit”;

për Bosnjë-Hercegovinën – “libreza e marinarit”.

3. Ky dokument do të garantojë ripranimin e mbajtësit të saj në vendin, i cili e ka lëshuar atë.

Neni 10

1. Anëtarët e ekuipazhit të një anije të secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të një dokumenti identiteti të vlefshëm, të lëshuar nga e njëjta Palë, siç referohen në nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje, do të lejohen gjatë qëndrimit të anijes në portin e Palës tjetër Kontraktuese për të zbritur dhe qëndruar në qytetin portual pa vizë, kur kapiteni i anijes i ka pajisur autoritetet kompetente lokale me një listë të ekuipazhit.

2. Këta persona do të jenë subjekt i procedurave të kontrollit të vendosura ndërsa zbresin dhe hipin në bordin e anijes.

Neni 11

1. Secila Palë Kontraktuese do të njohë dokumentet e vlefshme të identitetit, të lëshuara nga Pala tjetër Kontraktuese, siç referohen në nenin 9, kur mbajtësit e dokumenteve të tilla kanë nevojë të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të kalojnë nëpër territorin e saj, të ngarkojnë në bord anijen e tyre, të kthehen në vendin e tyre ose për çdo arsye tjetër, të pranueshme për këtë Palë Kontraktuese, pavarësisht nga mënyrat e transportit të përdorura me kushtin që këta persona të zbatojnë ligjet dhe rregullat e Palës së njëjtë Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese do t'i lejojë anëtarët e ekuipazhit të një anije të Palës tjetër Kontraktuese të qëndrojnë në spitalet në territorin e saj për kohën e kërkuar për një trajtim mjekësor.



3. Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar, do të sigurojë ndihmën e nevojshme mjekësore për anëtarët e ekuipazhit të një anije të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 12

Dispozitat e neneve 9, 10 dhe 11 zbatohen për çdo person, i cili nuk është një shtetas i secilës Palë Kontraktuese, por që ka dokumentet e identitetit në vijim të dispozitave të konventave përkatëse të ILO dhe IMO, në të cilat Republika e Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovina janë anëtare. Dokumente të tilla identiteti do të lëshohen nga një Palë Kontraktuese përkatëse dhe do t'i japin mbajtësit të saj të drejtën e kthimit në vendin që e lëshon atë.

Neni 13

1. Dispozitat e neneve 9–11 të kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë normat dhe rregullat për pranimin dhe largimin e të huajve në/nga territori i secilës Palë Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese kanë të drejtën e tyre të mohojnë hyrjen dhe qëndrimin në territorin e tyre të personave dhe të anijeve, që konsiderohen të padëshirueshme.

Neni 14

Për qëllimet e drejtimit të sigurt, kapitenët e anijeve të secilës Palë Kontraktuese do të kenë të drejtën, në mënyrë që të vazhdojnë udhëtimin, të rekrutojnë anëtarë ekuipazhi nga Pala tjetër Kontraktuese. Punësimi do të jetë vullnetar dhe në pajtueshmëri me legjislacionin e shtetit, flamurin e së cilës mban anija.

Neni 15

1. Nëse një anije ose një anije e marrë me qira e Palës Kontraktuese e humbur në det, ngec në cekëtinë, mbetet në rrëzë apo pëson ndonjë aksident tjetër pranë brigjeve të Palës tjetër Kontraktuese, autoritetet kompetente të kësaj të fundit do t'i japin të njëjtën mbrojtje, ndihmë dhe bashkëpunim pasagjerëve, ekuipazhit, vetë anijes dhe ngarkesës së saj, ashtu siç do t'ia jepnin edhe një anijeje, që mban flamurin e vet kombëtar.

2. Nëse një anije e Palës Kontraktuese pëson dëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ngarkesa e saj, furnizimet e saj dhe prona të tjera do të përjashtohen nga TVSH-ja, taksat doganore dhe taksat, përveç se në rastet kur ato janë paracaktuar

për konsum dhe përdorim direkt në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të anulojnë ligjet, që rregullojnë ruajtjen e përkohshme të mallrave, në territoret e Palëve Kontraktuese.

Neni 16

Ndërmarrjet dhe organizatat e flotës detare të secilës Palë Kontraktuese do të kenë të drejtën të themelojnë zyra agjencie në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Veprimtaria e këtyre zyrave do të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet e vendit, në territorin e së cilës ato janë themeluar.

Neni 17

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë ndërmarrjeve dhe organizatave të flotës detare të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën të përdorë, për qëllime pagese, të ardhurat dhe burime të ardhurash, të fituara nga aktivitetet e transportit detar, në territorin e të mëparshmit.

Secila Palë Kontraktuese do t'u japë ndërmarrjeve dhe organizatave të flotës detare të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën t'i transferojnë këtyre të fundit të gjitha të ardhurat, që mbeten mbas kryerjes së pagesave të lartpërmendura. Duke bërë kështu, ndërmarrjet dhe organizatat e flotës detare do të pajtohen me legjislacionin kombëtar në fuqi.

2. Të gjitha pagesat, që lindin nga aktivitetet e rregulluara nga kjo Marrëveshje, do të bëhen në çdo monedhë të huaj të konvertueshme, të pranueshme për organizatat e interesuara të të dyjave Palëve Kontraktuese.

Neni 18

1. Kur kryhet një krim në bordin e anijes të një Pale Kontraktuese, ndërsa ndodhet në detin territorial të Palës tjetër Kontraktuese, do të zbatohen dispozitat e nenit 27 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit (1982).

2. Dispozitat e këtij neni nuk shkelin të drejtat e inspektimit dhe të kontrollit nga autoritetet e secilës Palë Kontraktuese, në pajtim me ligjet e tyre përkatëse kombëtare.

Neni 19

Kur është e nevojshme, përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese do të takohen në mënyrë të vijueshme në Republikën



e Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës për të diskutuar çështjet, që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë çështje tjetër me interes të ndërsjellë, në lidhje me transportin detar.

Neni 20

Çdo mosmarrëveshje, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet përmes negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Nëse nuk mund të arrihet marrëveshje përmes negociatave të drejtpërdrejta, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 21

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar kohe dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të dytë, me të cilën Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se të gjitha kërkesat e legjislacionit kombëtar, që zbatohen në vendet e tyre përkatëse, janë përmbushur sipas rregullit.

2. Secila Palë Kontraktuese mund, pas kërkesës për konsultime, të propozojë amendamente për këtë Marrëveshje.

3. Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës, në të cilën është marrë njoftimi nga Pala tjetër Kontraktuese.

4. Bërë në Sarajevë, në datën 31.10, viti 2016, në dy kopje origjinale, në shqip dhe në gjuhët zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe) dhe në gjuhën angleze. Të gjitha tekstet do të jenë njëloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve, do të mbizotërojnë teksti anglisht.

5. Të nënshkruarit të autorizuar sipas rregullit nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
BOSNJË-
HERCEGOVINËS

VENDIM

Nr. 98, datë 15.2.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT NËN ADMINISTRIMIN E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT TË MATERIALEVE ARKIVORE TË ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT, QË GJENDEN NË MINISTRINË E MBROJTJES, MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT DHE NË AUTORITETET E TJERA PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 43, pika 1, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) dhe autoritetet e tjera publike t’i dorëzojnë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në vazhdim “Autoriteti”, të gjithë materialin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga data 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, pavarësisht nga data e grumbullimit të këtyre dokumenteve në arkiv. Në këtë dokumentacion përfshihen:

a) të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, që mund të jenë dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;

b) riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore;

c) mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;

ç) dokumentacioni shoqërues, procesverbalet, aktet e dorëzimit dhe aktet e marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni që prej datës së krijimit të tyre;

d) raportet e detajuara për të gjitha lëvizjet, ndryshimet, rigrupimet, dëmtimet dhe humbjet që



ka pësuar fondi i dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit si edhe dokumentacioni tjetër i sipërpërmendur, prej datës 2 korrik 1991 e në vijim;

dh) konstatimet, informacionet, urdhrat dhe raportet e hartuara, që kanë lidhje me menaxhimin, sistemimin, inventarin dhe gjendjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që janë grumbulluar në arkivin e institucioneve prej krijimit të tyre;

e) çdo informacion mbi procesverbalet e inventarizimit dhe regjistrat e të gjitha llojeve që i përkasin periudhës së sipërpërmendur si dhe çdo e dhënë tjetër që do t'i shërbejë punës së Autoritetit.

2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit vendosin pa afat në dispozicion të Autoritetit mjediset e çdo infrastrukturë tjetër të arkivave, ku janë të magazinuar dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe punonjësit e këtyre arkivave. Nëse në të njëjtin mjedis disponohen edhe dokumente të tjera të klasifikuara, atëherë institucioni vë në dispozicion një mjedis tjetër të përshtatshëm për shfrytëzimin e këtij dokumentacioni. Ky afat përfundon me transferimin e plotë të dokumenteve arkivore në arkivin e Autoritetit.

3. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 miratojnë listat e punonjësve të pajisur me certifikatë sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, të propozuar nga Autoriteti për të hyrë në mjediset arkivore të këtyre institucioneve.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit ia kalojnë Autoritetit përgjegjësinë e dhënies së informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përfshirë edhe lëshimin e vërtetimeve në përgjigje të kërkesave të subjekteve fizike dhe juridike, publike dhe private, që lidhen me këto dokumente.

5. Autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit i krijojnë menjëherë mundësitë dhe kushtet e punës Autoritetit, që, në bashkëpunim me strukturat e tyre përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, ky Autoritet të fillojë sa më shpejt të japë përgjigje ndaj kërkesave për informim

të institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera, të parashikuara në ligj.

6. Autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përcaktojnë një program të përbashkët pune për kalimin e materialit arkivor, duke respektuar afatet e përcaktuara në ligj.

7. Punonjësit dhe personat përgjegjës, që ushtrojnë detyrën për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, në arkivat e autoritetit publik, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes e Shërbimit Informativ të Shtetit, gjatë procedurës së kalimit të këtij dokumentacioni arkivor nën administrimin e Autoritetit, do të jenë pjesë e grupeve të punës që do të bashkëpunojnë me Autoritetin për të përmbushur detyrat e tij ligjore.

8. Grupet e punës drejtohen nga Autoriteti. PAGESA e anëtarëve të grupeve të punës kryhet nga institucioni ku ata bëjnë pjesë.

9. Punonjësit e përmendur në pikën 7, të këtij vendimi, me kërkesë të tyre dhe me miratimin e institucionit pranë të cilit ushtrojnë detyrat, mund të transferohen pranë Drejtorisë së Arkivit të Autoritetit. Për nëpunësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, që do të transferohen pranë Autoritetit, të zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

10. Brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe autoritetet e tjera publike të dërgojnë pranë Autoritetit emrat e personave, të cilët do të jenë pjesë e grupeve të punës.

11. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit duhet të kenë kaluar në administrim të Autoritetit të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe çdo autoritet publik për zbatimin e këtij vendimi.



Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, programit dhe shtyllës së financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
12 ditë kalendarike pas botimit në Fletoren zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 2, të këtij vendimi.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (në Kryeministri), <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm pranë sekretariatit teknik në ministri.</u>
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas shtojcës III të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projekt-vendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3 ditë pune nga dërgimi i propozimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik koordinon dhe organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.



Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për secilin projekt

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë Sekretariatit Teknik.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.130 /2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Shtrirja hapësinore e projektit ☐ Lokal ☐ Ndërvendor ☐ Rajonal ☐ Ndër-rajonal	Në rastet kur aplikuesi është bashki, shtrirja e projektit mund të jetë lokale ose ndërvendore kur projekti shtrihet në më shumë se një bashki. Për aplikimet ndërvendore mes dy apo më shumë njësi të qeverisjes vendore duhet të bashkëngjitet në aplikim edhe marrëveshja e partneritetit e lidhur midis tyre. Në rastet kur aplikuesi është agjenci zhvillimi, shtrirja e projektit mund të jetë rajonale ose ndër-rajonale. Për aplikimet rajonale dhe ndër-rajonale, agjencitë aplikuese duhet të bashkëngjisin në aplikim edhe marrëveshjen e partneritetit të lidhur midis tyre dhe/ose 2 apo më shumë bashkive.
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen; - Grafiku i punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.



Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë dhe i bizneseve që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar / Gjatësi rruge e trajtuar etj. (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyr projektin apo në rast se është projekt rruge të specifikohet gjatësia totale e rrugës që ndërtohet apo rikonstruktohet dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohet të jenë këto kosto, si do të sigurohen etj. - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohej është e njëjtë me koston total të projektit (në çdo rast vlera të jetë me TVSH).
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore apo nga donatorë.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera në monedhën Lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën Lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale).	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.



Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: - Projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. - Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioritetëve. - Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. - Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik / projektin e zbatimit; - preventivin; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - CD; - përllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, WGS 84 UTM 34 N.
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf
Pamje 3-dimensionale (*)	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

- Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:
 - aplikimi *online* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.) ose
 - me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Zhvillimit Urban.
- Formati i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni /subjekti aplikues.
- Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyruesht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.



Shtojca III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM (Shtylla I, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”)

Këto kritere përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë** i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Kriteret/kërkesat e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt, i përcakton sekretariati teknik.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore apo agjencitë e zhvillimit rajonal. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
3. Ndikimi i projekteve dhe avantazhet në promovimin e potencialeve të qyteteve, lehtësimit të aksesit dhe ndërveprimit midis zonave urbane e rurale, përmirësimit të qendrave dhe jetës komunitare, si dhe zhvillimit ekonomiko-social, në shërbimet publike parë nga ana e përfituesit, qytetarë dhe/ose biznes: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve /përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 140 lekë